


PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN THERTORE

INVESTITOR: SUBJEKTI "NERITAN DOKA"



THERTORE TOPULLARAJ
NIPT: L533296030
NERITAN DOKA


Paraqisni një përmbledhje të kërkesave për leje mjedisi, pa specifikuar detajet teknike.

Përmbledhja duhet të identifikojë të gjitha efektet mjedisore të njohura, të cilat kanë lidhje me kryerjen e aktiviteteve në instalim, dhe përshkruani masat ekzistuese ose të propozuara që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis.

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

Përshkrimi:

- Instalimi dhe aktivitetet e tij;
 - Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi;
 - Burimet e shkarkimeve nga instalimi;
 - Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes;
 - Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis;
 - Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme;
 - Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur;
 - Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme);
 - Masat për përdorimin eficient të energjisë;
 - Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:
 - Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;
 - Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme;
 - Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi;
- Informacioni i mësipërm duhet të përfshihet në **Aneksin 14**.
-



1. Instalimi dhe aktivitetet e tij;

1. HYRJJE.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk është i rëndësishëm vetëm për njërezit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qeniet në tokë. Njërezit duhet të kuptojnë se si përdorimi i burimeve mjedisore dhe përfitimet që vijnë nga ato të mos demtohen por të jete e mundur të përfitohet sot dhe në të ardhmen.

Termi mjedis dhe burime natyrore përdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qartë që i përkufizon.. Burimet natyrore i referohen burimeve të tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrit që rrethon tokën, çdo gjë që rritet në tokë apo det si dhe burimet që gjenden nëntokë. Mjedisi është me gjithpërshirës, çdo gjë që na rrethon.

Thjesht duke përdorur burimet natyrore në rrezikojmë në mbipërdorimin dhe shterimin e tyre. Shterimi i burimeve natyrore është një nga problemet thelbësor të çrregullimit të mjedisit. Në të përfshihet shterimi i ujit, mineraleve përfshirë dhe lëndet fosile si dhe shumë burime të tjera.

Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqërohet edhe me impakt në mjedis. Pra, impakti mjedisor i referohet ndryshimit të mjedisit natyror nga aktiviteti njërezor. Kemi dy tipe të impaktit mjedisor

- shterimi i burimeve
- ndotja

Në mënyrë që të shmangim këto probleme njërezimi duhet të mesojë se si të menaxhohen burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Pra, zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore nuk është gjë tjetër veçse përdorimi i tyre në mënyrë ekonomike nga brezat e sotëm për të lënë këto burime të përdoren edhe nga brezat që do të vijnë.


Qëndrueshmëria përfshin menaxhimin e gjithë perberësve dhe burimeve natyrore e njëzore me qëllim që të pasurohen me kalimin e kohës dhe të sigurohet një mirëqenie për të gjithë. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk i pranon politikën e cilat çojnë në uljen e bazës prodhuese dhe lënë gjeneratat e ardhshme me perspektivë me të ulta (të varfëra) dhe/ose rreziqe me të mëdha se të tonat. Teknologjitë që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm përfshijnë kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjisë së riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kërkime shkencore.

Problemet mjedisore në vendin tonë lidhen me ndotjen e ajrit në qytetet kryesore, ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujërave të ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane të cilat jo të gjitha depozitohen në vendet e caktuara.

Në vendin tonë zhvillimi blektoral, fale dhe suvenconëve nga shteti nga viti në vit, njëritje të krereve si organizimin e blektorise në formë fermash të vogla dhe të mëdha, ku bagetite janë të kontrolluara, të vaksinuara dhe mishit është i një cilësie brenda standarteve.

1.2 LEGJISLACIONI

- VKM nr.419 date 25.6.2014 “Per miratimin e kerkesave te posaçme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja”.
 - Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
 - Vendim nr. 13 date 4.1.2013 “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis”.
 - Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”.
 - Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”.
 - Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”.
 - Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.
 - Udhezim nr.1 date 03.03.2009 “Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis”.
 - Udhezim nr.3 date 19.11.2009 “Per metodologjine e raportit te VNM”.
 - Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 “Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”.
 - Udhezimin nr. 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”
 - VKM. Nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
 - Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”,të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
 - Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
 - Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”
 - Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
 - Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.
 - Ligji nr. 8094 date 21.03.1996 “Per largimin publik te mbeturinave“.
 - Ligj nr.52/2020 date 30.04.2020, Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, Datë 14.7.2011, “Për Lejet eMjedisit”, të Ndryshuar.
 - Ligj nr.53/2020 date 30.04.2020, Për disa ndryshime në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011, “Për Mbrojtjen eMjedisit”, të Ndryshuar.
 - Urdheri nr.163datë .16.06.2020 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e aplikimeve për leje mjedisi te Tipit B, për instalimet ekzistuese të paisura me leje mjedisi të Tipit C, të cilat në vartësi të kapacitetit prodhues,klasifikohen si leje mjedisi te Tipit B, si dhe rregullat e hollesishme për shqyrtimin e tyre nga QKB-JA”;
-



1.3 PROFILI I ZHVILLUESIT TE AKTIVITETIT.

Subjektifizik “Neritan Doka” liçensuar me NUIS: L53329603 G për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në fushën e “Tregëtimit të mishit dhe të nënprodukteve të tij.” ushtron veprimtarinë e tij në Bashkinë Gjirokastrë. Aktiviteti I këtij subjekti në fushën e tregëtimit të mishit dhe të nënprodukteve të tij zhvillohet prej më shumë se 10 vite. Thertorja është ndertuar dhe ka filluar aktivitetin në vitin 2012.

**SUBJEKTIFIZIKË SHITË REGJISTRUAR NË QKBMENR.NIUS L53329603
GSI PERSONFIZIK.**

Adresa e subjektit është: Qarku Gjirokastrë, qyteti/fshati: Valare, Adresa: Topullaraj, rrugë nacionale Valare – Gjirokastrë, objekti nr. 166/16

Nr. Tel 0694600200

Aktualisht për përmbushjen e standarteve të thërjes dhe tregëtimit të mishit conform legjislacionit Shqiptar dhe të BE subjekti synon ndërtimin e një thertore moderne.

Pozicioni gjeografik

Vendi i përzgjedhur për instalimin e thertoresh (duke rikonstruktuar dhe ndryshuar destinacionin e godinës ekzistuese) ka marrë në konsideratë kërkesat gjeografike të kërkuara nga ligji. Kushtet që duhet të plotësojë objekti në funksion të aktivitetit të kërkuar me të gjithë aksesoret funksional janë:

- Të jetë jashtë qendrës së banuar;
- Të jetë larg ndërtesave të tjera;
- Të mos ketë vështirësi në transport;
- Të jetë afër rrugës automobilistike;

Vendi i përzgjedhur nga subjekti për ndërtimin e thertoresh ndodhet në krahun e majtë të aksit rrugor Valare – Gjirokastrë në vendin e quajtur Topullaraj, objekt me nr. Pasurie 166/16, fshati Valare, Njësia administrative “Lunxheri”. Objekti i përzgjedhur ndodhet në

pjesën lindore të qytetit të Gjirokastrës, rreth 2.5 km nga zona urbane. Subjekti posedon në formë pronësie një sipërfaqe toke prej 6720m² të ish ndërmarrjes Bujqësore, të përfituar conform legjislacionit Shqiptar. Në këtë sipërfaqe subjekti zotëron me

dokument pronësie një sipërfaqe trualli prej 1340m² (5380m² janë tokë arë) në të cilën është ndërtuar një thetore

Sipërfaqet funksionale të objektit do të jenë të betonuara dhe pjesa dekorative do të jetë e gjelbëruar për të siguruar mirëfunksionim. Në instalim do të mbahen vetëm kafshët e planifikuar për therje dhe asnjë kafshë tjetër me mundësi përhapje infeksioni, sikurse mace, qen, brejtës, etj. Rrugët e planifikuar për shfrytëzimin e thetores do të mirëmbahen dhe nuk do të kryqëzohen midis tyre. Bëhet fjalë për rrugët e hyrje-dalje të prodhimit apo dhe ushqimit, por dhe për rrugët e qarkullimit të bagëtive. Në pjesën jugore do të gjenden hyrja kryesore, mjedise veshje/zhveshje, dhoma para frigoriferike e karkasës së gjedhëve, venddepozitimi i detergjentëve, i mjeteve të pastrimit, i mjeteve të amballazhimit, dezinfektuesit, dhoma veterinare, dushet, WC. Hapësira e punës për realizimin e proceseve teknologjike do të jetë e organizuar në hapësira të ngrohta dhe të ftohta dhe qarkullimi në hapësirat e impiantit planifikohet të jetë me rrugë një drejtim qarkullimi për mos krijim ndotje.

Në pjesën veriore dhe lindore të impiantit (mund të konsiderohet dhe si pjesa e papastër) do të gjenden:

- Vendqëndrimi i kafshëve për therje;
- Vend pastrimi dhe dezinfektimi i mjeteve transportuese të kafshëve;
- Vend grumbullimi dhe ruajtja e produkteve të papërdorshme;
- Hapësira e planifikuar për grumbullimin e mbeturinave;
- Rrugë kalimi, depozitimi dhe përpunimi i ujrave të ndotura konform kërkesave ligjore;
- Pjesa e planifikuar për shërbime teknike të pajisjeve teknologjike;
- Vend qëndrimi i mjeteve motorike të impiantit;
- Vend grumbullimi i mbeturinave;
- Vend grumbullimi idhe përpunimi i lëkurave;
- Vend grumbullimi dhe përpunimi i të brendshmeve;
- Vend depozitimi i mishit të kontaminuar;
- Komunikimi i instalimit me daljen e tipologjive të mbetjeve në

mjedis; Ndërsa në pjesën perëndimore dhe jug-perëndimore do të

instalohen:

- Dhoma e ftohjes së karkasës së bagëtive të imta;
 - Dhoma frigoriferike;
 - Komunikimi i instalimit me daljen e
-

produktit. Pjesa qendrore e instalimit përbëhet

nga:

- Rampa hyrëse për gjedhët dhe bagëtitë e imta;
- Pika e trullshjes së kafshëve (në dy seksione sipas tipologjisë);
- Pika e shgjakësimit të kafshëve (në dy seksione sipas tipologjisë);
- Linja teknologjike e gjedhëve për:
 - a. - heqje brirë dhe thundra,
 - b. - makineria e rjepjes,

Kjo fazë e veprimtarisë ka të bëjë me rikonstruksione dhe ndërtime në objekt në funksion të instalimit të thertores. Objekti do të ketë këtë përbërje:









Përbërja e skemës funksionale të Thertores

- Hyrja kryesore
 - Ambjente veshje/zhveshje
 - WC
 - Dushe
 - Veterineri
 - Dezinftim
 - Hyrja e gjedhëve
 - Hyrja e bagëtive të imta
 - Trullosje e gjedhëve dhe varje H= 4.5m
 - Trullosje e të imtave dhe varje H = 3m
 - Vend shgjakosja e të imtave
 - Vend shgjakosja e gjedhëve
 - Platforma për heqjen e brirëve dhe të thundrave
 - Makineria për rjepjen e gjedhëve
 - Platform për heqjen e kokës dhe të brendshmeve
 - Platform për prerje gjatësore të karkasës së gjedhëve
 - Platform për kasapët e të imtave
 - Sterilizim dhe pajisje
 - Karroca transporti të brendshme
 - Kontroll veterinar postmortum
 - Grumbullim mbeturinash
 - Grumbullimi dhe përpunimi i lëkurave
 - Pika e pastrimit të brendshmeve
 - Pika e përpunimit të brendshmeve
 - Pika e izolimit të mishrave me sëmundje
 - Mjedisi ftohës për karkasën e të imtave
 - Mjedisi ftohës për karkasën e gjedhëve
 - Pika e shpërndarjes së produktit të gatshëm
 - Dhoma frigoriferike
 - Zyrat
 - Pika e daljes dhe largimit të mbetjeve
 - Padoku
 - Pika e kontrollit paramortal
-

➤ Pika e magazinimit të aksesorëve të instalimit

Të gjitha mjediset do të kenë sipas funksionit dhe përdorimit sistemin e ndriçimit, ujit të ngrohtë e të ftohtë, ajrimit, ventilimit dhe kanalizimeve përkatëse. Aredimi i brendshëm i çdo sektori do të bëhet konform kërkesave të sipërcituara në regjimin teknologjik dhe sanitar të një thetore.

Pra veprimtaria ndërtimore do të ketë të bëjë në pjesën dërmuese të saj me materiale të gatshme ose gjysmë të gatshme, çka nuk do të krijoj gjatë ndërtimit ndonjë impakt të ndjeshëm në mjedis. Hapësira e brendshme e impiantit të thetores me të gjithë aksesorët funksional (me përjashtim të pjesës ku qëndrojnë bagëtitë) do të jetë e shtruar me beton. Hapësira rrethuese do të jetë e sistemuar për grumbullimin e ujrave atmosferike. Sistemi i kanalizimit do të pajiset me gropë dekantuese që të gjitha rrjedhjet teknologjike sipas ligjit për mbrotjen e mjedisit.

1 Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi;

Ne procesin teknologjik të thetores kapaciteti I projektuar është I ndryshëm sipas kërkesave të treguat , po rendisim mesatarisht lëndet e para që perdoren:

-bageti të trasha , gjedhe 10 krer ne dite

-bageti të imta 30-50 krere/dite

-energji elektrike 1500kv/muaj

-uje 5m³ / dite

Lende ndihmëse

-veshje personeli 300 kg/muaj

-detergjente lares dhe disifektant 4-6kg/muaj

-Vegla pune, thika , pistoleta për zaptim, aparat elektronarkoze, pistoleta pa plumba etj.
Sasia variable

-produkte perfundimtare

- mish vici 25ton/muaj

-mish qengji , keci 12 ton/muaj

-lekura 1100 cope/muaj

Pjeset e kembimit do te furnizohet nga subjekte te licencuara per import, ruajtje dhe tregtim te pjeseve te kembimit ne Republikën e Shqiperise.

Materiale te ndryshme per ambllazhimin e produktit te perpunuar do te furnizohet nga subjekte te licencuara per import, ruajtje dhe tregtim te tyre ne Republikën e Shqiperise.

Energjia elektrike do te furnizohet nga OSHE me kontrate ashtu siç eshte kryer deri me sot.

3.Burimet e shkarkimeve nga instalimi;

1.1 Shkarkimet në ajër.

Kryerja e aktivitetit ne thertore do te sjell emetime minimale te pluhurave ne mjedis gjate kryerjes se procesit, por me masat e mara keto pluhura nuk kane mundesi te ngrihen ne ajere. Burime te tjera ndotese mund te krijohen nga levizja e makinerive ngarkuese dhe trasportuese por me masat e mara per lagjen e siperfaqes se impiantit keto pluhura nuk mund te ngrihen ne ajer dhe ta ndotin ate. Burime te tjera ndotese per ajrin nuk do te kete

Shkarkimet e mundshme dhe fluruese.

Aktiviteti nuk ka emetime te mundshme fluruese nuk perdoren komponimeve organike te avullueshme.

Shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë.

Objekti gjatë shfrytëzimit të tij do të gjeneroj tre tipologji ujrash të ndotura për të cilat që në ndërtim planifikohet ndërtimi i rrjeteve të mëvetësuar. Përkatësisht:


- a. Rrjeti i kanalizimeve të ujrave atmosferike (të bardha)
- b. Rrjeti i kanalizimeve të ujrave teknologjike
- c. Rrjeti i kanalizimeve të zeza.


Ujrat e bardha sistemohen vetëm nëpërmjet sistemit të kanalizimeve dhe nuk kërkojnë asnjë trajtim paraprak (**subjekti është i detyruar që të mos shkarkoj asnjë tipologji tjetër në këtë sistem kanalizimesh**) të cilat do të jenë pjesë e sistemit të kanalizimit të parcelave bujqësore që e rrethojnë thertoren. Ujrat atmosferike nëpërmjet sistemit

vertikal dhe horizontal me tubacion të mbyllur ose/dhe të hapur ose nëpërmjet kanaleve të betonuara të instaluara përreth hapësirës së instalimit do të drejtohen për në rrjedhje të lirë në kanalën perëndimor (sipas skemës hidroteknike duke instaluar 4 pusetë në këndet e instalimit. Përkundrazi ujrë teknologjike dhe ato të zeza duhet që paraprakisht të nënshtrohen trajtimit primar duke ndërtuar gropat dekantuese sipas projektit.

Në hapësirën punuese të thertores ku uji është pjesë e proceseve teknologjike rrjedhja e tyre është projektuar nëpërmjet sistemit të kanaleve të mbyllura dhe me pjerrësi, për mos përhapje në sipërfaqe, çka do të përbente burim infeksioni, madje sistemi i funksionimit të tyre duhet të jetë i tillë që të mos ketë kthim aromash të pakëndshme në mjediset e thertores dhe njëkohësisht të jenë të pajisur me rrjetë për pengim qarkullimi të materialeve të ngurta apo gjallesave infektuese në të dy drejtimet.

Skema e grumbullimit të ujrave sipas burimit të gjenerimit dhe më pas të menaxhimit të tyre paraqitet më poshtë.





Pikat e planifikuara për ndërtimin e gropave dekantuese të planifikuara për tu instaluar jashtë instalimit (5 grupa në seri) për ujrat teknologjike dhe koordinatat e tyre sipas sistemit Gauss Kruger Zona 4 (1942) (shigjetat e kuqe nga lart poshtë):

$X_1 = 4427625.733$ $Y_1 = 4440743.231$ (dekantues i linjës së lëkurës dhe të brendshme) $X_2 = 4427617.193$ $Y_2 = 4440711.300$ (dekantues grumbullues)

$X_3 = 4427613.257$ $Y_3 = 4440706.325$ (dekantues grumbullues)

$X_4 = 4427607.697$ $Y_4 = 4440699.087$ (dekantues grumbullues)

$X_5 = 4427600.986$ $Y_5 = 4440690.949$ (dekantues grumbullues)

Pika e instalimit të padokut sipas sistemit koordinativ Gauss Kruger Zona 4 (1942) është:

$X = 4427624.781$ $Y = 4440739.310$ (rreth 30 m në distancë nga instalimi i thertores)

Pika e fillimit të lëvizjes në mbetjeve blegtoriale të ngurta nga instalimi për të pikat e jashtme të trajtimit sipas sistemit koordinativ Gauss Kruger Zona 4 (1942) është:

$X = 4427614.776$ $Y = 4440751.596$

Shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve.

Nuk do të ketë shkarkime të ujerave në rrjetin e kanalizimeve.

Shkarkimet në tokë.

Shkarkime të elementeve kontaminues për tokë nuk do të ketë, jo vetëm brenda sipërfaqes së impiantit, por edhe në zonën përreth tij. Jashtë instalimit të parashikuar në projekt nuk do të ketë asnjë shkarkim në tokë që mund ta ndoti atë. Për rastet aksidentale të rrjedhjes së karburanteve nga mjetet e punës shoqëria do të marrë masat e menjehershme për pastrimin e vendit.

Shkarkimet e zhurmës.

Zhurmat në fazën e ndërtimit janë eliminuar pasi impianti ka shumë vite që është ndërtuar dhe nuk ka sjellë asnjë shqetësim për banorët e zonës pasi në afërsi të impiantit nuk ka pas dhe nuk ka objekte dhe banorë që do të rrezikoheshin.

Paisjet e makinerit qe do perdoren ne kete aktivitet do plotesojne direktiven 2000/1/14/CE te Parlamentit Evropian dhe e KE 8 maj 2000, do jene te standartit te aplikueshem ne BE per zhurmat.

Emetimi i zhurmave nga proçesi i punes sic e kemi thene edhe me larte jane minimale dhe nuk krijojne asnje shqetesim ne objekte te tjera fqinje , mgjs objekti kufizohet me hapësira te Keto zhurma vleresohen ne nivele te lejueshme,por megjitheate rekomandohet qe punetoret te perdorin mjete mbrojtese per tu mbrojtur nga ndikimi i zhurmes.

Gjate fazes se funksionimit vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal dhe nuk mund te kete influyence te rendesishme ne instalim.

Siç thame edhe me siper, zhurmat qe do te krijohen gjate procesit te punes ne objekt jane vetem ato te shkaktuara nga makinerite e shfrytezimit ,te ngarkimit e te transportit te cilat ato jane brenda normave.

Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes;

Vlerësimi i Ndikimit të Shkarkimeve në Ajër.

Përshkruani gjendjen aktuale të cilësisë së ajrit duke i kushtuar vëmendje të veçantë standardeve për cilësinë e ajrit.

Tregoni nëse shkarkimet në ajër mund të shkaktojnë dëme apo ndikojnë negativisht në mjedis, pavarësisht se mund të jenë brenda vlerave kufi të siguruara nga aplikimi i teknikave më të mira të disponueshme (TMD). Nëse vërehet erë e pakëndshme jashtë ambienteve të instalimit, duhet të bëhet një vlerësim i erës së pakëndshme, duke patur parasysh shpeshtësinë/frekuencen dhe vendndodhjen e shfaqjes së saj.

Shkarkimet në ajër nuk mund të shkaktojnë dëme apo ndikojnë negativisht në mjedis, pavarësisht se janë brenda vlerave kufi. Ato sigurohen nga aplikimi i teknikave më të mira të disponueshme (TMD). Nuk vërehet erë e pakëndshme jashtë ambienteve të instalimit, prandaj nuk eshte e nevojshme të bëhet një vlerësim i erës së pakëndshme, duke patur parasysh shpeshtësinë/frekuencen dhe vendndodhjen e shfaqjes së saj.

Nuk kemi shkarkime ne ajer ose qe te kete erera te pakendeshme se aktiviteti zhvillohet ne nje ambient te mbyllur , kanalet dekantuse jane te mbyllura, po ashtu edhe gropat jane te mbylluara

Jepni informacion të detajuar mbi vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve ekzistuese apo të parashikuara në mjedis, duke përfshirë edhe vendin/mjedisin në të cilin nuk janë çliruar ende shkarkimet.

Përfshini në Aneksin 6 modelet e shpërndarjes së shkarkimeve në ajër, të krijuara nga proceset e ndryshme në instalim. Të gjitha modelet dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me sa më sipër, duhet të përfshihen në Aneksin 6.

Cilesia e ajrit ne zonen e studiuar.

Persa i perket cilesise se ajrit ne zone ai konsiderohet me parametra brenda normave duke qene se ndodhet larg zonave te banuara dhe nuk eshte i ndotur nga veprimtarite e industrise. Edhe zhvillimi i aktivitetit ne thertore , eshte i vetmi ne ate zone dhe nuk do te shkaktoj ndotje te ajrit sepse nuk do te kete emetime te gazeve ndotes.

Duke marrë edhe parasysh që qendrat e banuara janë në një distancë relativisht të largët nga zona ku do të ushtrohet aktiviteti i perpunimit dhe ku do të punojnë këto makina, ndikimet do të jene minimale.

Emetimet e tjera në ajër përfaqësohen vetëm nga gazrat e makinerive me djegje të brendëshme të kompresorit të makinave të ngarkimit dhe të mjeteve transportit që do të përdoren për perpunim. Gjithashtu nje ndikim fare i vogel vjen edhe nga gjenerimi i grimcave te pluhurit, qe shkaktohet nga levizja e mjeteve te transportit gjate proceve ne thertore

Kushtet hidrogeologjike te zones se impiantit.

Për vetë përbërjen gjeologjike, morfologjinë, pasuritë pyjore, pozicionin në lidhje me masat e ajrit që vijnë të ngarkuara me avuj uji nga veriu ne jug , mund të thuhet se zona ku ndodhet objekti nuk është shumë e pasur me ujëra sipërfaqësore. I vetmi basen ujr me i madhe ne ate rajon eshte baseni I lumit Drino qe este larg influences se veprimtarise se subjektit thertore .

Vegjetacioni i kësaj zone është i pasur me flore bimore , barishtore se ndodhet ne siperfaqe qe jane toka bujqesore.

Niveli i zhurmave ne zonen e studiuar.

Ne afersi te projektit nuk ka veprimtari te cilat te shkaktojne zhurma mbi nivele te lejuara. zhurmat qe do te krijohen en aktivitetin e thertoresh jane minimale , ne nivele shume me te ulta se ato te lejuara me ligj.

Ne afersi te objektit qe kerkohet te kryhet aktiviteti nuk ndodhen shtepi dhe keto jane shume large.

Pershkrim i vegjetacionit ne secilin habitat dhe statusit te ruajtjes kombetar dhe nderkombetar te tyre.

Vegjetacioni I bimesise eshte sghume I zhvilluar, nuk kemi zhvillime te pyjeve poer vetem zhvillim te bimesise se ulet dhe asaj te kultivuar, jonxhe , trifil, etj. Nuk kemi habitate qe mbrohen me ligje te vecanta ose jane te rrezikuara .

Pershkrim i faunes ne secilin habitat dhe statusit te ruajtjes kombetar dhe nderkombetar te tyre.

Prania e objektit në një sipërfaqe që prej shumë vitesh është shfrytëzuar si tokë bujqësore me monokultura apo kultura të kufizura, prania e rrugëve komunikuese për automjetet dhe njerëzit e komunitetit përreth, mungesa e larmishmërisë floristike shoqërohet me mungesë larmishmërie biologjike. Pra nuk ka shumë kafshë të tipit gjitar, por gjenden minj, vidra (*Lutra lutra*) specie e shtratit të lumit Drinos dhe lakuriq të natës. Prania e burime ujore shumë të pastra në zonën përreth projektit dhe më gjerë janë shumë të rëndësishme sidomos për ruajtjen e bashkësisë së disa specie të rrezikuar si lakuriqi i natës (përfaqësues të rendit **Chiroptera**) dhe vidra (**Lutra lutra**), të cilat janë specie me interes global dhe rajonal. Ndërsa më pak gjenden shpendë kryesisht lloje të që janë të adaptuara për mjedise dhe habitate bujqësore dhe ujore d.m.th shpendë të fushave të hapura, të kopshteve, gëmushave dhe lagunave. Megjithëse aktiviteti në linjën e thertores dhe distanca e instalimit të tij nga shtrati i lumit Drinos nuk ka impakt të drejtëpërdrejtë në parametrat e lumit. Theksojmë se lugina e lumit Drino përfaqëson rrugë të rëndësishme për shtegëtimin e shpendëve sidomos të **Falco naumani** që aktualisht është një specie në rrezik zhdukje, por dhe të përfaqësuesëve të F. Laridae, etj. Zona përreth projektit ka zvarranikë të ndryshëm (nga 37 specie që gjenden në Shqipëri në këtë trevë gjenden 18 lloje) por që nuk rrezikohen. Gjithashtu më me shumicë gjenden insekte të llojeve të ndryshme, amfibë, peshq dhe mikrogjallesa.

Largësia e objektit nga shtrati i lumit Drino dhe natyra e produkteve të veprimtarisë së tij në thertore, bëjnë të mundur që influenca në regjimin e shpendëve që jetojnë, ushqehen dhe shumohen përgjatë lumit dhe më gjerë në zonë si dhe të vetë organizmave ujor (kryesisht peshqëve) të jetë pothuajse inekzistente. Kjo bëhet e mundur edhe nga realizimi i procesit teknologjik dhe i planit të menaxhimit në linjën së thertores.

Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis;

Shkarkimet në ajër.

EMETIMET NË AJËR

Po ashtu edhe ndotja e ajrit do të jetë prezente gjatë punimeve ndërtuese. Kryesisht parashikohet të ketë ndotje nga çlirimi i gazeve dhe grimcave të mjeteve motorike gjatë djegjes së karburantit dhe shumë më pak nga punimet apo qarkullimi pasi mjedisi ka lagështirë të konsiderueshme.

KRIJIMI I MBETJEVE

Si rezultat i aktiviteteve punuese do të kemi gjenerim të mbetjeve të ngurta, sidomos inerteve. Por planifikimi i sistemit të tyre në kufirin midis objektit dhe rrugës hyrëse i kthen ato në element të ripërdorshëm pa impakt mjedisor. Burimi i inerteve janë: gropa septike, gropat dekantuese, gropat e ç'gjakosjes, linja e transmetimit të ujrave

teknologjike, gropa septike, instalimi i vend qëndrimit të kafshëve dhe sistemime qarkulluese. Volumi i mbetjeve të gjeneruara vlerësohet: 05-10m³ linja e trajtimit të



ujrave teknologjike + 2m³ dekantuesit e ç'gjaksimit + 2m³ Këto mbetje do të menaxhohen në hapësirën e pronës së subjektit.

Ndryshimi i relievit ekzistues

Praktikisht aktiviteti nuk ka të bëjë me ndryshim të relievit ekzistues. Vetëm sipërfaqja ndërtimore do të nivelohet, ndërsa të gjitha punimet e tjera do të respektojnë relievin ekzistues.

Ndikime në trashëgiminë kulturore

Nga analiza e impaktit të këtij aktiviteti rezulton se në zonën ku do të zbatohet projekti:

- Nuk ka objekte të kultive fetare;
- Për ndërtimin nuk do të ketë nevojë për ndërtim rrugësh të reja por do të shfrytëzohen ekzistueset;
- Nuk ka kisha, xhamia ose objekte të tjera fetare të vendosura në 30 m distancë nga kufijtë e projektit.
- Siç është specifikuar edhe më lart, nuk janë identifikuar zona me vlera kulturore dhe historike.

Objektet kulturore që ndodhen në distancë nga objekti nuk do të kenë asnjë impakt nga aktiviteti ndërtues dhe shfrytëzues.

Ndikimi në larminë biologjike

Ky impakt është vlerësuar në dy drejtime: **së pari** nga sipërfaqja biologjike e tjerësuar dhe **së dyti** nga influenca e shfrytëzimit të sipërfaqes së kërkuar si mjedis pedologjik dhe fizik në biologjinë përreth tij. Aktualisht një sipërfaqe e ish tokës bujqësore prej 1340 m² tashmë është e tjetërsuar, prandaj nga aktiviteti i subjektit do të mund të përshtatet në funksion të instalimit rreth 400 m² tokë vreshtari por që nuk do të ndryshoj destinacion, pasi do të jetë komplementare e shërbimit në instalim (kryesisht do të përdoret për bagëtitë). Por nuk bëhet fjalë për ndonjë larmishmëri biologjike, pasi hapësira është tërësisht e kultivuar. Prandaj impakti negativ mjedisor i instalimit të këtij objekti vlerësohet minimal. Ndërkohë

që koha relativisht e shkurtër e instalimit do të minimizoj impaktin negativ mjedisor në regjimin e biodiversitetit të mjedisit përreth. Shfrytëzimi i thertoresh do të shoqërohet me procese operacionale që do të realizohen vetëm në hapësirën e brendshme të tij dhe me qarkullim të vogël jashtë rrugëve ekzistuese duke mos krijuar impakt negativ mjedisor në hapësirat kufizuese të impiantit. Mbarështrimi i bagëtive në padok apo ushqyerja në tokën e subjektit nuk krijon impakt negativ mjedisor. Ndërsa ndikimi i shfrytëzimit të thertoresh në biodiversitetin përreth si

efekt sekundar është i lidhur me trajtimin e mbetjeve apo rrjedhjeve të saj. Sistemi i konceptuar i kanalizimeve dhe tratimit primar të rrjedhjeve minimizon impaktin e thertores në biodiversitet. Meqënëse thertorja pozicionohet në raport me hapësirën e luginës së lumit Drinos, biologjia e të cilit është thelbësore respektimi i masave të propozuara në këtë VNM paraprake dhe ato të lejes Mjedisore përbëjnë detyrim për zhvillimin e aktivitetit përputhës me mjedisin dhe pa impakt negativ mjedisor.

SHKARKIMI I UJËRAVE

Aktiviteti ne thertore nuk do te kete shkarkim te ujrave ne siperfaqe te cdo lloj tipologjie

Shkarkimet e mundshme dhe fluruese.

Aktiviteti nuk ka emetime te mundshme fluruese nuk perdoren komponimeve organike te avullueshme.

Shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë

Sic e kemi pershkruar edhe me larte proceset teknologjike ne thertore nuk kane shkarkime ne ujerat siperfaqesore

Ujerat tekonologjike qe dalin nga therja e bagetive si dhe gjaku kanalizohen dhe sistemohen ne kanale te vecanta dhe shkarkohen ne gropat septike te posacme

Shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve.

Nuk do te kete shkarkime te ujrave ne rrjetin e kanalizimeve.

Shkarkimet në tokë.

Sipas procesit tekonologjik sic e kemi pershkruar edhe me larte nuk ka shkarkime te ujrave ne toke , sepse nepermjet kanalizimeve te mbylluara shkarkohne ne gropa septike .

1. Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme;

"Teknikat më të mira të disponueshme" (TMD) do të thotë faza më efektive dhe e avancuar në zhvillimin e aktiviteteve dhe metodat e tyre të veprimit të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për të siguruar në parim bazat për vlerat limite të emetimeve të percaktuara për të parandaluar dhe ku nuk është e praktikueshme, në përgjithësi për të reduktuar emetimet dhe ndikimin i tyre në mjedis në tërësi:

- "Teknika" përfshin të dyja si teknologjine e përdorur dhe mënyren në të cilën impianti është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, operuar dhe çmontuar;
- "Teknikat më të mira të disponueshme" do të thotë ato që janë zhvilluar në një shkallë që lejon zbatimin në sektorin përkatës industrial, nën kushte ekonomike dhe teknike të zbatueshme, duke marrë parasysh kostot dhe përparësitë, nëse janë apo nuk janë përdorur ose prodhuar teknikat brenda territorit të Pales në fjalë, për aq kohë sa ato janë mjaft të lejueshme për operatorin;
- "Më të mirë" do të thotë më efektiv në arritjen e një niveli të përgjithshëm të lartë të mbrojtjes së mjedisit në tërësi.

Në përcaktimin e teknikave më të mira të disponueshme, konsideratë të veçantë duhet t'i jepet, në përgjithësi, ose në raste të veçanta faktorëve të mëposhtëm, duke pasur parasysh kostot më të mundshme dhe përfitimet nga një masë dhe parimet e masës paraprake dhe parandalimit:

- Përdorimi i teknologjisë më mbetje të pakta;
- Ripërpunimi i mëtejshëm dhe riciklimi i substancave të gjeneruara dhe të përdorura në proces dhe i mbetjeve;
- Proçeset e krahasueshme, pajisjet apo metodat e funksionimit të cilat kanë qenë provuar me sukses në një shkallë industriale;
- Përparimet teknologjike dhe ndryshimet në njohuri shkencore dhe të të kuptuarit;
- Natyra, efektet dhe vëllimi i emetimeve në fjalë;
- Datat e montimeve për instalimet e reja apo ekzistuese;
- Koha e nevojshme për të futur teknikën më të mirë të mundshme;
- Konsumi dhe natyra e lëndëve të para të përdorura në proces dhe efikasitetin e saj të energjisë;
- Nevoja për të parandaluar apo zvogëluar në minimum ndikimin e përgjithshëm të emetimeve në mjedis dhe rreziqet për të;
- Nevoja për të parandaluar aksidentet dhe për të minimizuar pasojat e tyre për mjedisin.

Koncepti i teknikave më të mira të disponueshme nuk i drejtohet këshillimit të ndonjë teknike ose teknologjie të veçantë, por marrjes parasysh të karakteristikave teknike të impianteve në fjalë, pozitën e saj gjeografike dhe kushtet lokale mjedisore.

Në këtë instalim me masat e mara mund të themi se pothuajse shkarimet do të jenë minimal ose për të thene që nuk do të ketë shkarkime në lumin Drino. Shoqëria ka ndërtuar katër vaska dekantimi

ASPEKTET MJEDISORE DHE TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.**Toka**

Përdorimi i Tokës.

- Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion.
- Respektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
- Ruajtja e kompaktësisë lidhëse të masës së burimit që shfrytëzohet.

Erozioni

Mbrojtja nga erozioni.

- Ndërtimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut.
- Krijimi i rrugëve dhe shesheve, me bazament të qëndueshëm dhe hapërsirë të mjaftueshme për lëvizjen e lirë të mjeteve dhe punonjësve.

BiodiversitetiVegjetacioni
Dëmtim potencial i
Vegjetacionit.

- Zbatimi i rregullores së brendshme, duke respektuar rigorozisht masat teknike,
- Punime me mbrojtje brënda objektit, lagia e tokës.
- Mos cënimi i territoreve bujqësore kufitare.
- Rrethimi i perimetrit të zonës në perpunim me prita të gjalla (bimësi e marrë nga zona në shfrytëzim).

FaunaShqetësim i specieve,
dëmtim aksidental i tyre

- Rrethimi i perimetrit të zonës në impiant me bimësi autoktone.
- Ndërprerja e procesit të punës në rastet konstatimit të specieve të ndryshme, deri në sigurimin e plotë të tyre.
- Personeli i thertores ka për detyrë shpërnguljen e çdo specie që jeton brënda zonës së projektit si edhe trajtimin e tyre tek veterineri në rast aksidentesh.
- Paisja e zonës me tabela informuese për llojet e specieve që ndodhen në zonën në shfrytëzim.

Cilësia e ajritRritje e emetimeve të
CO₂, SO₂, NO_x, PM, HC
(VOC) nga djegia e
karburantit të
automjeteve
lëvizëse.

- Mjete me kolaudim optimal.
- Pjesë kembimi rezerve brënda objektit për raste emergjente.
- Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburanti cilësor.
- Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës.
- Përdorimi i marmitave katalitike.
- Evitimi i mbajtjes ndëzuar të mjeteve të punës në rastet kur në objekt nuk punohet.

Parandalimi i pluhurave

- do të përdoret lagia e terreneve nën punë dhe lagia e vendgrumbullimit të materialit të nxjerrë. Kjo do të evitohet edhe

	ndotjen gjatë transportit.
Sistemi i kullimit	
Sistemi i kullimit.	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut, në çdo zone te impiantit dhe bashkimi i tyre në një kolektor të përbashkët, ku do të realizohet edhe dekantimi i ujrave të turbullta, në vaskën (gropen) e dekantimit. - Rehabilitim i rrjedhjeve biologjike të ndodhura në zone
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në thertore .	<ul style="list-style-type: none"> - Transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësi vendore. - Vënd grumbullim i diferencuar. - Rikuperim. - Riciklim.
Ujërat e Ndotura Urbane	
	<ul style="list-style-type: none"> - Gropat e përkohshme septike. - Pastrimi periodik nga firma të nënkontraktuara. - Minimizimi i konsumit të ujit.
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve.	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i mjeteve të kolauduara. - Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjate orareve të përshtatshme.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor.Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve.	<ul style="list-style-type: none"> - Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.

Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur;

Subjekti NERITAN DOKA është I pari subject që kandertuar thertore bashkohore ne rrethin e Gjirokastrës . Vendi I ndertimit te thertores është ne qender te zones se Lunxherise ne nje zone fushore (fusha e Valarese) dhe rreth 2km ne lindje te qytetit te Gjirokastrës, popullsia e te cilit është edhe konsumatori me I madh I mishit te prodhuar ne thertore . Subjekti është paisur me lejet perkatese te industrise ushqimore si dhe me leje mjedisi tipi C miraturar nge Drejtoria Rajonale Mjedisit Gjirokasterme NR 248 prot. Nr indetifikimi te lejes 36 dt 06.08.2018, akt miratimi I lejes tipi C , publikuar ne QKL me PN -7883-08-2018, kodi III.1a pa afat. Data e leshimit nga QKL-ja 24.08.2018.

Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme);

Parandalimi i mbetjeve do të minimizohet duke zbatuar rigorizisht teknologjine në thertore si dhe rinovimin e saj here mbas here.

Riciklimi i mbetjeve bëhet për mbetje si brirë, lekura thindrat e kembeve dhe pleh organik.

Masat për përdorimin eficient të energjisë;

Subjekti në objektivat e saj ka pas si synim që të përdori në mënyrë eficiente përdorimin e energjisë. Kjo është e lidhur ngushtesisht edhe me koston e prodhimit të produktit të tregtueshëm. Sa më e lartë të jetë kostoja e prodhimit të produktit të përpunuar aq më pak konkurrenca bëhet në tregun e produktit i shoqërisë sonë. Makineritë e montuar në këto impiant janë zgjedhur të tilla që të kenë një fuqi të instaluar sa më ekonomike. Janë marrë masa që humbjet e energjisë në rrjet të jenë sa më të ulta. Makineritë përzgjidhen gjatë punës që të mos punojnë të gjitha në një kohë dhe të punojnë kohë piku.

Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:

- ✓ Janë marrë masa të nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;
- ✓ Janë ndërmarrë masa të nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme;
- ✓ Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi;

Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:

- Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për vazhdimin e funksionimit të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.
 - Aktiviteti kryesisht do të zhvillohet në ambient të mbyllur kështu që nuk do të ketë nivele zhurmash domethënëse për zonën përreth. Do të bëhet pajisja e punonjësve me mjete mbrojtëse personale.
 - Subjekti ka ndërtuar një sistem të grumbullimit të ujërave të pastrimit të mjeteve dhe makinereve/pajisjeve dhe ujërave sipërfaqësorë dhe devijimit të tyre në vaskat e dekantimit, brenda sipërfaqes së impiantit.
 - Subjekti do të bëjë një monitorim sistematik për prurjet e ujit dhe me shtimin e tyre janë marrë dhe do të merren masa për kanalizimin dhe drenimin e tyre jashtë kontureve të thertores, në pjesën perendimore të impiantit.
 - Teknologjia shfrytëzimit të objektit parashikon përdorimin e ujit në procesin teknologjik duke ulur në minimum ndotjet që do të vijin nga kryerja e prodhimit në të thatë.
 - Krijimi i kanaleve të kullimit në kantier ku ujërat e tyre do të mblidhen në gropën e dekantimit
 - Nga ky aktivitet nuk parashikohen të ketë ndikime në ndryshimin e habitateve
 - Nuk kemi gjenerimin e mbetjeve të rrezikshme.
 - Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të grumbullohen në kazan të veçantë. Kazanet do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e përcaktuar nga Njësia Administrative Lunxheri dhe
-

bashkia Gjirokastrë për mbetjet urbane. Mbetjet e paketimit do të mbledhen dhe dorezohen në kompani të licencuara për përdorimin, riciklimin apo trajtimin e tyre.

- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë, si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë. .

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara.

Nuk kërkohet konsum i madh i karburanteve, kjo do të çojë në uljen e ndotjeve nga gazra që do të leshojnë motorat e makinerive lehtësuese dhe transportuese.

Kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive me efikasitet.

Percaktimi i vend-parkimit të automjeteve, si dhe pajisja e vend-parkimeve me sinjalistikën përkatëse. Është instaluar sistemi i udhëzimit për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelberim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagjia me ujë e rrugicave të brendshme gjatë periudhës Maj-Tetor, Mbetjet e ngurta urbane të prodhuara, do të depozitohen në koshat e vendosur brenda objektit ku zhvillohet veprimtaria dhe më pas do të transportohen periodikisht në konteneret të percaktuara nga njesia vendore, ku do të jetë një sasi prej 0.4 kg/dite për person.

Është realizuar tokenimi i rrjetit elektrik për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konformë kushteve teknike,

- ✓ **Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;**

Rreziku në shëndet dhe masat për zbutjen e tij, masat e sigurimit teknik.

- Rreziku në mjedis në kryerjen e procesit të thyerjes së bagetive është present prandaj duhet të merren masa për eliminimin e tyre të rreziqeve
 - Stafit i shoqërisë dhe drejtuesit i ngarkuar me këto punë duhet që një herë në tre muaj vazhdimisht të kryhet instruksionin teknik të punonjësve.
 - Një metode efikase mbetet trajnimi teorik jo më shumë se tre javë dhe trajnimi në punë.
 - Si trajnim në punë këshillohet të punohet në mbikqyrje për jo më pak se një javë në të gjitha proceset e transportit.
 - Për evidentimin e efektit të zhurmave në punonjësit e impiantit gjatë operacioneve që gjenerojnë zhurmë të lartë (siç janë përcaktuar në pjesën ku ato trajtohen) është i nevojshëm përdorimi i kyfjeve të zhurmës.
 - Për reagimin e menjëhershëm ndaj aksidenteve të mundshme humane, thertorja do të ketë edhe një ambient të mbyllur të konsideruar si zyrë ku do të mbahet kutia e ndihmës së shpejtë dhe do të vendosen mjetet personale të punonjësve. Çelsat e këtij ambienti do të ruhen me kujdes dhe njëkohësisht do të jenë në dispozicion të kujdesit që nevojitet në çdo orë të ditës.
 - Për uljen e rrezikut të aksidentimit të banorëve nga mjetet e transportit në rrugë buzë fshatit shpejtësia e mjeteve të mos i kalojë 20 km /orë.
-

Sigurimi teknik në proceset e punës.

Zbatimi i normave të rregullores së teknikës së sigurimit.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit në impiantin e perpunimit subjekti duhet të mbajë parasysh që problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë më të rëndësishmet dhe më të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

- Para se gjithash në të gjitha operacionet do të punësohen specialiste me eksperience pune në kryerjen e proceseve të
- Drejtuesi teknik i punimeve para fillimit të punës do të zbatojë rregullat dhe normat e përcaktuara në Rregulloren e Teknikës së Sigurimit për Industrinë
- Rregullorja e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të punimeve dhe subjektit, do të zbatohet në çdo proces pune të përcaktuar në plan organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga ai dhe të miratuar nga drejtuesit e firmës.
- Plan organizimi i punimeve do të hartohet para fillimit të procesit .
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve.
- Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar do të bëjë kontrollin teknik dhe azhurnimin e saktë të punimeve të procesit teknologjik të thertores të çdo lloji për të cilat subjekti ka marrë liçence.
- Rradha e kryerjes do të përcaktohet hollesisht në planin e masave tekniko organizative dhe do të miratohet nga perfaqësuesi ligjor i shoqërisë.
- Në këtë plan tekniko-organizativ masat e teknikes së sigurimit do të jenë vendin kryesor.
- Drejtuesi teknik i punimeve do të kryejë instruktive të rregullta mujore e tre mujore, ku do të trajtohen tema të veçanta për të gjitha profesionet.
- Riparimi i avarive, gratatimi dhe punime të tjera kur makinerite janë në levizje të mos kryhet për asnjë rast pasi mund të shoqërohet me aksidente.
- Frontet e punës në zbatimin e objektit, po të punohet natën duhet të ndriçohen me projektore që furnizohen nga rrjeti elektrik në mënyrë të pa varur nga ndriçimi individual i mjeteve motorike. Kur mungon ndriçimi ndalohet puna.
- Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit të zones.
- ✓ **Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të normale;**
- ✓ Subjekti në objektivat e saj ka pasur synim që të përpunojë në mënyrë efikente gurin që do të përpunojë në këtë impiant. Kjo shoqëri në synimet e saj ka jo vetëm përpunimin e mishit por edhe ruajtjen e shëndetit të punonjësve dhe mbrojtjen e ambientit nga ndotja. Kjo shoqëri ka marrë masat e duhura duke hartuar **Plani i Përballimit të Emergjencave, Projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe menjehere**, ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme;

Plani i Përballimit të Emergjencave.

Subjekti në veprimtarinë e saj, për aktivitetin në impiantin THERTORE detyrohet të planifikojë, të organizojë dhe të realizojë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimtaria.

Subjekti ka për detyrë:

- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të njoftojë personelin si dhe autoritetet e AKM, ISHMPU, DRM dhe Njesia Administrative Lunxheri dhe bashkia Gjirokaster për një rrezik imediat.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjence në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Te nderhyje ne menyre te menjehershme ne rast te dukurive natyrore apo emergjencave.
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

Emergjencat në këtë objekt, mund të vijnë nga këto shkaqe:

- **Rënia e zjarrit.**

Në rastin e rënies së zjarreve, në territorin e Shoqërisë është e afishuar skema e lajmërimit. Mbi bazën e kësaj skeme personeli që ndodhet në Shoqëri vepron duke bërë njoftimin e PMNZSH në numrat e zjarrfikëseve të afishuara në tabelat përkatëse.

Brenda aktivitetit do të funksionojë edhe lidhja telefonike dhe telefonat celulare që janë vendosur në dispozicion për lajmërimin e zjarrfikësve. Personeli prezent bazuar në skemën e afishuar vepron menjëherë me fikset e dorës dhe tenton të kufizojë përhapjen e mëtejshme të zjarrit.

Pajisjet dhe instalimet do të mbrohen me sistemin e shkumës antizjarr, si dhe shuarës zjarri portabel dhe të lëvizshëm, të vendosur në vende të sigurta.

- ✓ **Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi;**

Veprimtaria monitoruese.

Në bazë të veprimtarisë plani i monitorimit ndër të tjera do të përmbajë:

- Monitorimin e mbrojtjes nga pluhurat.
- Monitorimin e mbrojtjes nga zhurmat.
- Monitorimin e masave për mbrojtjen nga aksidentet.
- Monitorimi i ndikimit të përmytjeve të territorit nga rreshjet.
- Monitorimi i sipërfaqeve të mbjella.

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve etj, kryhet sipas disa kritereve shkencore përsa i përket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe atë të faktorit natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore. Monitorim është procesi të prodhimit, perpunimit, të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Proçesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse. Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si AKM-ja, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ISHMPU, MIE, etj.

Monitorimi i parametrave që duhet të kontrollohen dhe koha.

Parametri.	Frekuenca e monitorimit.	Aksesi në vendndodhjet e matjeve.	Metoda e marrjes së mostrave.	Metoda/teknika e analizës.
Lende e ngurte (LN)	Çdo 6 muaj	Lehtesisht i arritshem	Laborator i Akredituar	Laborator i Akredituar
PM10	Çdo 6 muaj	Lehtesisht i arritshem	Laborator i Akredituar	Laborator i Akredituar
Grimcat	Çdo 6 muaj	Lehtesisht i arritshem	Laborator i Akredituar	Laborator i Akredituar
Cilesia e ujrave	Çdo 6 muaj	Lehtesisht i arritshem	Laborator i Akredituar	Laborator i Akredituar
CO ₂	Çdo 6 muaj	Lehtesisht i arritshem	Laborator i Akredituar	Laborator i Akredituar
Zhurmat	Çdo 6 muaj	Lehtesisht i arritshem	Laborator i Akredituar	Laborator i Akredituar
Cilesia e Ajrit	Çdo 6 muaj	Lehtesisht i arritshem	Laborator i Akredituar	Laborator i Akredituar
Cilesia e Ujrave	Çdo 6 muaj	Lehtesisht i arritshem	Laborator i Akredituar	Laborator i Akredituar
Ujrat teknologjike	Çdo 6 muaj	Lehtesisht i arritshem	Laborator i Akredituar	Laborator i Akredituar